



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

01 NR. 06-3874/17

KLINË, 16.6.2017

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË VI-të TË KPF, MBAJTUR, MË 16.6.2017, NË ORËN 10.00, NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryesuesi i KPF-së, dr. Haxhi Ibishi, drejtori i Drejtorisë së FEZH, Ramiz Rrusta, përfaq. të KFOR-it, përfaq. të OSBE-së, OJQ “Koha” etj.

Mbledhjen e hapi dhe udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe iu uroj mirëseardhje në këtë mbledhje të KPF-së.

“Kam një kërkesë nga Drejtoria FEZH, për futjen në rend të ditës për vënien në diskutim publik të plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores për tatimin në pronë”, theksoi kryesuesi, i cili pasi që nuk pati debat rreth çështjes bosht, ai vuri në miratim kërkesën e Drejtorisë së FESH, në mënyrë që Rregullorja e tatimit në pronë të vihet në diskutim publik për ndryshim.

Me vota unanime u miratua kërkesa, e cila njëherësh u përfshi në pikën e rendit të ditës, Të ndryshme.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës.

Me vota unanime u miratua ky

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar të KPF-së,
3. Shqyrtimi i Draft-strategjisë për Zhvillimin Ekonomik të Komunës 2017-2021,
4. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) – periudha 2018-2020,
5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Transparencës në Komunën e Klinës 2017,
6. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë së FEZH për vënien në diskutim publik për ndryshimin e Rregullores së tatimit në pronë.
7. Të ndryshme.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi se nuk ka mungesa të anëtarëve të KPF-së.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi hapi diskutimin rreth procesverbalit të seancës së kaluar.

Nuk pati debate.

Kryesuesi e vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

Me vota unanime u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika e tretë: Shqyrtimi i Draft-strategjisë për Zhvillimin Ekonomik të Komunës 2017-2021.

Kryesuesi foli rreth çështjes në rend të ditës. “Është mbajtur debati me publikun. Janë kryer procedurat përkatëse. Hapi debatin rreth Draft-strategjisë për Zhvillimin Ekonomik të Komunës 2017-2021.

Fadil Gashi, tha se është mirë për të na njoftuar detajisht rreth kësaj draftstrategjie. “E kemi marrë variantin e draft-strategjisë. A ka ndryshime me variantin që kemi marrë. Të na vijnë vërejtjet, propozimet dhe sugjerimet veç e veç dhe pastaj të inkorporohen me ndryshimet që kemi”, pohoi anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, sqaroi çështjen e ngrehur nga anëtari Gashi. “Nuk kemi asgjë nga ato propozimet, sugjerimet, përpos procesverbalit të debatit me publikun”, sqaroi kryesuesi.

Kryesuesi vuri në miratim për procedim në seancën e KK-së për shqyrtim dhe miratim.

Me vota unanime u miratua rekomandimi.

Pika e katërt: Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) – periudha 2018-2020.

Kryesuesi Ibishi foli rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) – periudha 2018-2020. Fjalën e barti te drejtori i Drejtorisë së FEZH, z. Ramiz Rrusta.

Ramiz Rrusta, dha sqarime kronologjike rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) – periudha 2018-2020. “Përpara e keni materialin. Korniza më datën 28.6.2017, duhet të vihet në diskutim me publikun, ndërkaq, më 30.6.2017, duhet të miratohet nga Asambleja komunale dhe pastaj të dërgohet në MF”, sqaroi drejtori Rrusta.

Kryesuesi Rrusta hapi debatin rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) – periudha 2018-2020.

Ndue Shabanaj, theksoi se mendoj që datat e debatimit në diskutim me publikun dhe të shqyrtimit dhe miratimit në AK, po më duken të përafërta. “Të debatohet me publikun më 28 qershor, ndërsa të shqyrtohet dhe miratohet nga Ak më 30 qershor, po me duket që janë dy data tepër të përafërta, domethënë distanca në mes këtyre dy datave janë tepër e shkurtër, përkatësisht shumë afër. Pra, periudha është tepër e shkurtër për diskutim me publikun dhe shqyrtimin dhe miratimin në AK. Këtë material e mora tash, mundësit tona janë tepër të kufizuara për të debatuar”, konstatoi prof. Shabanaj.

Fadil Gashi, theksoi se themeli i buxhetit duhet të fillojë nga kjo kornizë. “Është mirë për t’iu përmbajtur. Të gjitha dokumentet bazohen në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Komunal. Deri te seanca e radhës së AK shpresoj se do të plotësohet edhe të harmonizohet”, ka shtuar ndër të anëtari Gashi.

Kryesuesi vuri për miratim rekomandimin për procedim në seancën e KK_së.

Me 6 vota për, 1 abstenim, u miratua rekomandimi për procedim në KK.

Pika e pestë: Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Transparencës në Komunën e Klinës 2017.

Kryesuesi foli rreth çështjes në rend të ditës. Hapi diskutimin.

Fadil Gashi, tha se nuk e di cilat komuna e kanë miratuar një plan të këtillë. “Nuk di pse na ofrohet ky plan kur dihet mirëfilli që për transparencë kanë obligim ligjor. Një çështje e tillë është planifikuar me ligj. Mendoj, që do të ishte më mirë sikur të kërkojmë se deri ku kanë mbërritur me transparencë”, pohoi anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, theksoi pasi që të gjitha komunat tjera kanë vepruar njëjtë edhe ne vendosëm që të përfillim një veprim të tyre. “edhe unë pajtohem që transparenca është obligim ligjor dhe nuk është e nevojshme të na ofrohet një plan i tillë. Zyra ligjore do të na sqarojë në seancën e radhës së AK”, shtoi kryesuesi, Ibishi.

Kryesuesi vuri në miratim rekomandimin për procedim në seancën e radhës së AK-së.

Me vota unanime u miratua rekomandimi.

Pika e gjashtë: Kërkesa e Drejtorisë së FEZH për vënien në diskutim publik për ndryshim të Rregullores për tatimin në pronë.

Kryesuesi foli rreth kërkesës së Drejtorisë së FEZH. Në vijim kryesuesi Rrusta lexoi kërkesën e Drejtorisë së FEZH.

Hapi debatin rreth çështjes. Nuk pati debate.

Kryesuesi vuri në miratim rekomandimin që Rregullorja për tatimin në pronë të vihet në diskutim publik, për ndryshim.


Me vota unanime u miratua rekomandimi.

Kryesuesi falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë.

Mbledhjen e konstatoi të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30 minuta.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI



Kryesuesi i KPF-së,
Dr. Haxhi IBISHI